



15-10-2018

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:013873  
Datë: 13.08.2018  
Numri i dokumentit: 00109280

P.nr.613/18

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal.** si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtari individual Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale sulm nga neni 187 par 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II. nr.798-1/18, e datës 24.04.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt.13.08.2018, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Mimoza Syla, të akuzuarit [REDACTED] të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari [REDACTED] me vendbanim në fshatin [REDACTED], Ferizaj, i lindur me [REDACTED], nga i ati [REDACTED] e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, prind i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa pune, me numër personal [REDACTED] mbrohet në liri.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**SEPSE:**

Me date 14.03.2018, rreth ores 19:10, në rrugën "12 qershori", Ferizaj, konkretisht në lokalitetin [REDACTED], prone e të demtuars [REDACTED] për shkak të mosmarreveshje të atëçastshme në mes të pandehurit dhe të demtuars, I pandehuri e ka përdorur forcën ndaj të demtuars duke e goditur me shuplake në fytyrë, ku edhe rrezohet në tokë, pa pelqimin e saj,-

**-Me këtë ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së.**

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, dhe 73 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së

## G J Y K O N D Ë N I M M E G J O B Ë

Të akuzuarit [REDAKTUAR], i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 150 /njëqind e pesëdhjetë / Euro, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në afat prej 90 ditësh, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

E dëmtuara [REDAKTUAR], me vendbanim ne rr. ' [REDAKTUAR] ' ne Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, dhe taksën në shumën prej 30 Euro, për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarimit të dhunshëm

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën PP.II. nr.798-1/18, e datës 24.04.2018, ka akuzuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale sulm nga neni 187 par 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.13.08.2018, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Mimoza Syla dhe i akuzuari [REDAKTUAR], e dëmtuara [REDAKTUAR] është ftuar për seance gjyqësore, por shpërndarësi i ftesave ne flet dërgesën për dorëzim personal me datën 20.07.2018 e ka njoftuar gjykatën se pala është e panjohur ne këtë adrese dhe nuk e njeh askush.

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarit janë respektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari [REDAKTUAR], në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, dhe ne vazhdim ka deklaruar se qendron prane deklaratës së dhënë në Stacionion Policor me datën 19.03.2018, se atë ditë ka shkuar tek kafeja ' [REDAKTUAR] ' se bashku me djalin e tij dhe tre shokë dhe aty kanë marrë nga një birrë e më pas djali i tij, deshi të shkojë ne tualet ku [REDAKTUAR] e ka pyetur se ku është tualeti, ajo e ka provokuar me

fjalët “pse po më pyet, si nuk e di dil jashtë është tualeti”, djali i ka thënë e ku është jashtë, pra ajo i tha këndeje është mos më provoko se ta nxijë jetën, une u ndiva keq kur e degjova dhe i kam shkuar tek tavolina [REDAKTUAR] dhe i kam thenë kujt ja nxin jetën ti a e din se është djali im [REDAKTUAR] e ajo i ka thenë se paski ardhur me qëllim të keq, por ky i thot jo se nuk ka ardhur për qëllim të keq dhe [REDAKTUAR] i ka thene une jam [REDAKTUAR] ja u ndaloj qytetin dhe shpirtin ju a marr, une nuk kam mund ta kontolloj veten në këto momente dhe e godita me shuplakë, i vie keq qe e ka kryer këtë veprë penale, dhe i premtom gjykates se në të ardhmen nuk do të perserisë vepra penale dhe me rastin e shqiptimit të dënimit kërkon nga gjykata që të merr për bazë se është i pa pune, qe ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit Mimoza Sylja, ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajësisë është bërë konform ligjit dhe pranimi mbështetet edhe me povat materiale që gjenden në shkresat e kësaj lënde dhe kërkon nga gjykata që të njejtin ta pranoj si të tillë.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale në: dekalraten e te pandehurit dhene gjate procedures se hetimeve ne stacionin policor me datën 16.03.2018, si dhe deklarata e te demtuarës dhënë në stacionin policor me datën 14.03.2018.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale penale “sulm” nga neni 187 par 1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë, pendimin e kryerjes së veprës penale, mbajtës i familjes premtimin se më nuk do të perserisë veprime të ngjashme, mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmërinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqiptoj dënim me gjobë në shumë prej 150 /njëqind e pesëdhjetë / Euro, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në afat prej 90 ditësh të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan në afat prej 90 ditësh, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si në diapozitiv duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Konform nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së, të dëmtuarin: [REDAKTUAR] nga Lipjani, rruga [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil

E dëmtuara [REDAKTUAR] me vendbanim ne rr. "[REDAKTUAR]" ne Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, e ka udhëzuar në kontest civil.

Numri i lëndës: 2018:013873

Datë: 13.08.2018

Numri i dokumentit: 00109280

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nënpar. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktmave të Krimit Nr.05/L-036.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,  
**P.nr.613/18 me datë 13.08.2018**

**Zyrtare Ligjore**  
Kadishe Shabani



**Gjyqtari**  
Adem Shabani



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.